




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



NR.01/2020

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 01/2020 PËR PËRCAKTIMIN E LARTËSIS SË TAKSËS VJETORE TË LICENCIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktohen lartësinë taksës vjetore dhe metodën e kalkulimit të taksës që duhet ti paguhet Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (në tekstin e mëtutjeshëm: (“ARRU”), nga të ardhurat bruto të ofruesit të shërbimeve i cili është licencuar nga ARR.U.

Neni 2 Fushëveprimi

Udhëzim Administrativ përcakton termat, kushtet dhe procedurat Ofruesit të Shërbimeve të Ujësjellësit, Ujërave të Ndotura dhe Furnizuesit e Ujit me Shumicë, krejt së bashku Ofrues të Shërbimeve, dhe në rast të bashkimit (shkrirjes) të ndonjë Ofruesi të Shërbimeve me një ose më tepër Ofrues të Shërbimeve, pasardhësin e tij.

Neni 3 Taksa e Aplikimit për Licencë

Ofruesi i shërbimeve i paguan ARR.U taksën e pakthyeshme të parapar me nenin 14 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-042, në shumën prej 200.00 € (dyqind euro), për paraqitjen e aplikacionit, në ditën kur aplikacioni për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime i është dorëzuar ARR.U-së.

Neni 4 **Taksa Vjetore e Licencimit**

1. Ofruesi i shërbimeve i paguan ARRU taksën e pakthyeshme vjetore të licencimit për vitin që fillon me 1 janar 2020 në pajtim me nenin 14 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-042.
Lartësia vjetore e Taksës së licencimit është përcaktuar të jetë 1.072 % e bruto faturimit vjetor të raportuara në pasqyrat e të ardhurave të tyre për vitin 2018 të atij Ofruesi të Shërbimeve të Ujit sipas shtojcës dy (2) të këtij udhëzimi.

$$\mathbf{X = B \times 100/t}$$

Ku:

X = Vlera e Taksës Vjetore të Licencimit e pagueshme nga secili Ofrues i Shërbimeve

B = Shpenzimet e parapara të ARRU për vitin 2020 (shih Shtojcën 1)

t = Qarkullimi vjetor bruto i Ofruesit të Shërbimeve për vitin 2018 (shih Shtojcën 2)

2. Në rast se një Ofrues i Shërbimeve është bashkuar me një apo më tepër Ofrues të Shërbimeve të Ujit, pasardhësi i tij duhet të paguajë taksën vjetore të licencimit që është e pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit që është bashkuar (shkrirë).
3. Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, dhe furnizuesit të ujit me shumicë, të Licencuar nga ARRU janë të obliguar të paguajnë Taksën Vjetore të Licencimit e cila është e ndarë në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta në çdo fillim të muajit të vitit kalendarik më së voni deri më datën pesë (5).

Neni 5 **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.02/2019 për përcaktimin e lartësisë së taksës vjetore për vitin 2019.

Neni 6 **Hyrja në Fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ për Përcaktimin e Lartësisë së Taksës Vjetore, hynë në fuqi me 1qershor 2020

Datë 29 / 05 / 2020
Prishtinë



Bashkangjitur në këtë udhëzim janë edhe shtojcat si në vijim:

Shtojca 1: Shpenzimet ARRU –s të Aprovuara me ligjin e buxhetit 2020

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në 2018 dhe

Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për Ofruesit e Shërbimeve për 2020

Shtojca 1: Shpenzimet Totale të ARRU- të Aprovuara për vitin 2020

SHIPENZIMET TOTALE TË ARRU NË 2020	
1. Shpenzimet e Personelit	248,090.00
2. Shpenzimet e Mallërave dhe Shërbimeve	127,770.00
3. Shpenzimet e Shërbimeve Publike	6,503.00
Gjithësejt Shpenzimet e ARRU	382,363.00

SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA DHE UJIT ME SHUMICË 2018			TAKSA VJETORE PER OFRUESIT E SHËRBIMEVE 2020		
Emri i Ofruesit të Shërbimeve	Regjioni	Qarkullimi bruto vjetor (EUR)	Emri I Ofruesit te Shërbimeve	Regjioni	Lartësia e taksës vjetore
Kompania Rajonale e Ujësllësit "PRISHTINA" sh.a.	Prishtina	14,311,278	Kompania Rajonale e Ujësllësit "PRISHTINA"	Prishtine	153,416.90
Kompania Rajonale e Ujësllësit "BIFURKACIONI" sh.a.	Ferizaj	2,163,193.00	Kompania Rajonale e Ujësllësit "BIFURKACIONI"	Ferizaj	23,189.43
Kompania Rajonale e Ujësllësit "GJAKOVA" sh.a.	Gjakovë	4,395,523.00	Kompania Rajonale e Ujësllësit "GJAKOVA"	Gjakove	47,120.01
Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI" sh.a.	Prishtinë	1,052,904.00	Ofruesi I Ujit me Shumicë "IBER-LEPENCI"	Prishtine	11,287.13
Kompania Rajonale e Ujësllësit "MITROVICA" sh.a.	Mitrovicë	3,330,751.00	Kompania Rajonale e Ujësllësit "UJESJELLSI REGJIONAL"	Mitrovice	35,705.65
Kompania Rajonale e Ujësllësit "HIDRODRINI" sh.a.	Pejë	3,760,089.00	Kompania Rajonale e Ujësllësit "HIDRODRINI"	Peje	40,308.15
Kompania Rajonale e Ujësllësit "HIDROREGJIONI" sh.a.	Prizren	4,367,127.00	Kompania Rajonale e Ujësllësit "HIDROREGJIONI"	Prizren	46,815.60
Kompania Rajonale e Ujësllësit "HIDROMORAVA" sh.a.	Gjilan	2,299,768.00	Kompania Rajonale e Ujësllësit "HIDROMORAVA"	Gjilan	24,653.51
Totali – Ofruesit shërbimeve te Ujit		35,680,632.80	Total taksa vjetore 2020		382,496.39

Shtojca 2: Qarkullimi Vjetor i Ofruesve të Shërbimeve në vitin 2018 të audituar nga ARRU si dhe Taksa vjetore e Licencimit për vitin 2020